REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.10.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:18 dhe mbaroi në orën 15:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltare Ligjore pranë Njësisë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Paola Ndroqi, përfaqësuese nga Universiteti "Epoka".

5. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

6. Edmond Hoxhaj

6. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

   1.1 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme".

   1.2 "Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar".[1]

Çështjet të cilat janë për trajtim në rendin e ditës të orës 15:15 lidhen me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme si dhe me caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Zoti Kurushi fton zonjën Alicanaj që të vijojë me relacionet për secilën nga kërkesat e paraqitura nga gjykatat që janë në nevojë.

Zonja Alicanaj merr fjalën dhe shprehet se për arsye teknike do të parashtrojë nga "account-i" tjetër.

Pas kërkesave të disa gjykatave propozohet fillimisht radha e procedurave të shortit:

A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

[1] Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

I. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

B. Gjykatat e Apelit sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm:

1. Gjykata e Apelit Korçë;

II. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Pasi anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime me radhën e procedurave të shortit, vijohet me relatimin e relacioneve përkatëse.

Për sa i përket kërkesës së ardhura nga **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale, dhe kërkohet caktimi i një gjyqtari për shqyrtimin e kërkesës së seancës paraprake nr.88, 6/123, dhe 18/98 të cilat i përkasin të njëjtit procedim të lidhur. Bashkëlidhur relacionit Komisioni ka paraqitur edhe listën e gjyqtarëve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të cilët plotësojnë kushtet për t'u shortuar për këtë kërkesë.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Dy janë gjyqtarët të cilët janë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm që kanë papajtueshmëri në këtë çështje pasi kanë pengesë sepse gjykojnë procedimin në themel lidhur me këtë të pandehur dhe janë caktuar më parë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, përkatësisht gjyqtari Petrit Çomo dhe gjyqtari Dritan Hasani.

Në këto kushte, referuar edhe listës së gjyqtarëve bashkëlidhur relacionit, procedurat e shortit janë gati për shortimin e këtyre gjyqtarëve që gjenden në këtë listë.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Diamela Goxha.

Vijohet me kërkesat e **<u>Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar</u>**, e cila ka paraqitur nevojë në 3 çështje, në lënde penale, ndërsa për një kërkesë tjetër Komisioni ka propozuar caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (lexohet të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion).

Dy çështjet e para në tabelën që shoqëron relacionin kanë të bëjnë me të njëjtin procedim penal, prandaj gjyqtarët që do të përzgjidhen ... (audio është e paqartë pasi ka shkëputje), pra duhet të jenë të ndryshëm.

Ndërkohë edhe propozimi për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} i përket një çështjeje që ka të bëjë me procedim të lidhur me kërkesat nr. 696 dhe nr. 697, është për çështjen nr. 59 të ardhura nga Gjykata e Posaçme e Apelit.

Ndërsa për kërkesën e tretë Komisioni vihet në lëvizje nga Gjykata e Apelit të Posaçëm pasi gjyqtari i zgjedhur më përpara për plotësimin e trupit gjykues, z. Toska, u dekretua anëtar i Gjykatës Kushtetuese, kështu që kjo çështje të ripërsëritet.

Bashkëlidhur relacionit Komisioni ka përgatitur edhe listën e gjyqtarëve të gjykatave të apelit të Republikës së Shqipërisë të cilët plotësojnë kushtet që të kenë përvojë profesionale prej 10 vjetësh dhe të paktën 5 vjet si gjyqtar në çështjet penale.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Fuat Vjerdha dhe Valdete Hoxha.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Astrit Kalaja.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha (që do plotësojë trupin gjykues).

Vijohet me kërkesat e **<u>Gjykatës së Apelit Korçë</u>** për plotësimin e trupit gjykues, kërkesa nr. 913 që ka të bëjë gjatë themelit të çështjes "Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve" është paraqitur një kërkesë për shuarje të masës, çfarë e ka bërë emergjente dhe të vihet në lëvizje gjykata me këtë kërkesë. Kërkohet delegimi i tre gjyqtarëve. Gjyqtarët Sonjela Voskopi, Dritan Hasani dhe Arta Duka kanë marrë pjesë në vendimin e gjykatës së apelit e cila është prishur nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu në relacion është detajuar që ka pengesë edhe gjyqtarja Emona Muçi pasi ka gjykuar çështjen në gjykatën e apelit Pogradec. Kërkesa tjetër ka të bëjë me një kërkesë

të karakterit penal “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”. Gjatë gjykimit të çështjes së themelit është kërkuar përjashtimi i gjyqtarëve Arta Duka dhe Dritan Hasani. Në këto kushte kërkohet delegimi i një gjyqtari për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim gjyqtari.

Lidhur me këto kërkesa të Gjykatës së Apelit Korçë është propozuar që gjykata e përzgjedhur të jetë Gjykata e Apelit Tiranë. Duke marrë në konsideratë të gjithë gjyqtarët që ushtrojnë detyrën pranë kësaj gjykate, përveç kryetares në detyrë Valdete Hoxha dhe zonja Emona Muçi që ka pengesë ligjore për çështjen nr.1 të referuar në tabelën që shoqëron relacionin. Për këtë arsye propozohet që për të dyja çështjet të përzgjidhen 3 gjyqtarë, duke marrë në konsideratë që në çështjen e parë kërkohen tre gjyqtarë dhe për çështjen e dytë një gjyqtar.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Ornela Naqellari (relatore), Marsela Dervishi dhe Irida Kacerja (anëtare).

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Alma Ahmeti (Zhupa).

(Ndërkohë, audio e zonjës Alicanaj nuk dëgjohet mirë.)

Komisioni ka hartuar edhe një projektvendim për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nga kjo gjykatë ka ardhur kërkesa 697, datë 30.09.2022 për gjykimin e çështjes penale nr. 59 pranë kësaj gjykate. Kërkohet plotësimi i trupit gjykues me një gjyqtar për shqyrtimin e çështjes me të pandehur Aldo Nesimi etj; akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/a, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

Duke qenë se gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} plotëson kushtet shtesë si edhe ato të vjetërsisë në detyrë dhe plotëson kushtet për të qenë i caktuar në këtë çështje, për këto arsye Komisioni ka propozuar dhe ka paraqitur projektvendimin që është i strukturuar në dy pika: Pika e parë e projektvendimit përcakton se gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...} etj; akuzuar për kryerjen e

veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/a, 28/4, 333/a/2, 334/1, 278/1, 236/2 të Kodit Penal (çështjen për të cilën gjykata paraqet nevojë).

Pika e dytë e projektvendimit përcakton se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjithashtu parashikohet edhe hyrja në fuqi menjëherë dhe publikimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Meqenëse edhe mikrofoni i zonjës Alicanaj pati probleme teknike, pyetet nga zoti Rusi nëse ka përfunduar relatimin në lidhje me caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} [...].

Konfirmohet nga zonja Alicanaj dhe ripërsëritet edhe një herë përmbajtja e projektvendimit të propozuar.

Ftohen anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutime.

Duke qenë se anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime rreth propozimit të ardhur nga Komisioni, hidhet në votim propozimi:

Irena Plaku është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ridvan Hado është dakord.

Alban Toro është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Yllka Rupa është pro.

Brikena Ukperaj është pro.

Klodian Kurushi është dakord.

Ilir Rusi është dakord.

Vendim "Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kërkesën penale me nr.{...} akti, datë 08.09.2022 regjistrimi me të pandehur {...} etj; akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1, të Kodit Penal.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor